



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 495/14 Prot.

Tiranë, më 16.04.2026

VENDIM

Nr. 31 Datë 16.04 2026

“PËR

MIRATIMIN E NISJES SË PROCEDURAVE PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT "MASTER NË TRAJNIM SPORTIV DHE USHQYERJE", MIDIS UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES DHE UNIVERSITETIT EUROPIAN TË MADRIDIT, SPANJË”

Mbështetur në nenin 3, 49 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës", Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, në nenin 7, 43 të Statutit të UST-së, në Rregulloren e UST-së, në shkresën nr. 606/2 prot., datë 26.03.2026 të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes "Përcjellje e propozimit për hapjen e Programit të Dyfishtë Master në "Trajnim Sportiv dhe Ushqyerje", midis Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Universitetit European të Madridit, Spanjë", në Vendimin e Senatit Akademik nr. 50 datë 03.04.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e dates 16.04.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e nisjes së procedurave për hapjen e programit të përbashkët Master në "Trajnim Sportiv dhe Ushqyerje", midis Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Universitetit European të Madridit, Spanjë.
2. Ky Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim Administratorit të UST-së , FSHL-së, si dhe Drejtorisë Së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al).

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

